

STATUT
I SHOQËRISË ITAF Sh.P.K.
SELIA LIGJORE KAVAJË

Sot, më 27.07.2023, në Kavajë,

Z. Federico Sagnotti, lindur në Formia (LT) ITALI, më 14/10/1993, me Kod Fiskal: SGNFRC93R14D70E, identifikuar me kartë identiteti nr. CA961200J;

I cili ka vendosur të themelojë shoqërinë “ITAF Sh.P.K.”, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe ta rregullojë sipas këtij Statuti i cili përmban këto kushte:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare **ITAF Sh.P.K.** rregullon pozicionin e saj juridik, marrëdhëniet mes themeluesve, organet e saj, llojin e shoqërisë, afatin e veprimtarisë, marrëdhëniet me punonjësit, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare”, dhe sipas rregullave të tjera të Legjislacionit Shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

(Aktiviteti)

Shoqëria ka si Objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

Konsulencë biznesi dhe korporate; Aktivitete konsulence në fushën e komunikimit dhe marketingut; Aktivitete të trajnimit, certifikimit, administrimit, programimit, kërkimit, orientimit dhe asistencës për shoqëritë dhe organet publike dhe private në përgjithësi; Aktivitete të auditimit të shoqërive; Veprimtari konsulence në hartimin e tenderëve publikë dhe privatë; Menaxhim, blerje, shitje, shkëmbim, marrje në dorëzim dhe dhënie me qira e pronave si për llogari të vet ashtu edhe për llogari të palëve të treta; Ofrim i shërbimeve në sektorët: “kontabilitet, administrim, financë dhe menaxhim i burimeve njerëzore”; Aktivitete të import-eksportit të produkteve; Aktivitete të telemarketingut dhe gjenerimit të klientëve, menaxhim i qendrave *call center* dhe telemarketing; Aktivitete të shërbimeve të reklamimit dhe marketingut, blerje dhe rishitje mallrash, shërbime menaxhimi, shërbime ndërmjetësimi, konsulencë biznesi; Aktivitete të tregtisë elektronike në distancë; Aktivitet brokerimi që synon lehtësimin e lidhjes së biznesit ndërmjet palëve të treta; Aktivitet dhënie me qira të biçikletave, mjeteve motorike, motoçikletave, varkave dhe avionëve, me ose pa drejtues. Menaxhim i objekteve akomoduese; Identifikim, promovim dhe ofrim i shërbimeve të trajnimit, aktiviteteve dhe eventeve për shpërndarje, informim dhe përgatitje për rritjen profesionale dhe personale të individit; Aktivitete të kërkimit dhe zhvillimit në fushën teknologjike dhe shkencore; Çdo veprimtari të lidhur me aktivitetet e mëparshme të parashikuara nga ligji shqiptar.

NENI 2

(Emri dhe selia ligjore e shoqërisë)

Shoqëria do të njihet me emrin e saj **ITAF Sh.P.K.**

Selia ligjore e shoqërisë do të jetë në adresën:

QAZIM FORTUZI 04040133, ND. 16, 2501 KAVAJE

NENI 3

(Regjimi ligjor i Shoqërisë)

Shoqëria bazohet në parimet e ekonomisë së tregut dhe synon realizimin e fitimit. Shoqëria respekton parimin e reciprocitetit.

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e shoqërisë i nënshtrohet dispozitave të aktit të themelimit, të Statutit dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e civil në fuqi.

Shoqëria mund të ndryshojë formën e regjimit juridik me vendim të Asamblesë së Ortakëve, bazuar në rregullat që do të jenë në fuqi dhe sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe të statutit, duke u përshtatur sipas amendamenteve përkatëse. Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

NENI 4

Ortakët do të jenë përgjegjës për humbjet brenda kufijve të kapitalit të investuar.

Mjetet e shoqërisë, që krijohen gjatë veprimtarisë së saj, do të jenë në pronësi të ortakëve, në përpjesëtim me kapitalin e investuar. Asetet mund të shiten, jepen me qira ose hipotekohen, me pëlqimin e ortakëve.

NENI 5

(Të drejtat e ortakëve)

Ortakët kanë të drejtë të administrojnë veprimtarinë e shoqërisë në përputhje me objektin e saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese dhe tregtare që mund të ushtrojë shoqëria, vlerat e saj intelektuale, ekonomike dhe financiare.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin kapitalin që zotërojnë, veprim i cili kryhet në bazë të kushteve të lejuara nga statuti dhe ligji.

Dorëheqja nga shoqëria nuk mund t'i çlirojë ortakët nga detyrimet që mbartin deri në momentin e dorëheqjes.

Ortakët kanë të drejtë, në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin, të jenë në të njëjtën kohë ortakë edhe në shoqëri të tjera.

NENI 6

(Kohëzgjatja e shoqërisë)

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar. Ortakët mund të vendosin për kohëzgjatjen e shoqërisë sipas vendimit të marrë në përputhje me statutin dhe ligjin.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 7

Veprimtaria e funksionimit të shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike krijohet sipas parimeve të llogaritjeve dhe pasqyrohet në pasqyrat financiare të shoqërisë.

NENI 8

Kapitali i investuar nga ortakët përbën bazën për krijimin e fondit të qarkullimit të veprimtarisë ekonomike.

Administratori u dorëzon ortakëve dokumentin e verifikimit për sasinë e shumave të paguara në fazën e themelimit.

NENI 9

Kapitali aksioner përbëhet nga kontributi i ortakëve të kësaj shoqërie në vlerën 5.000 lekë dhe ndahet në 1 (një) aksion.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një aksion me vlerë nominale 5.000 lekë, i cili ndahet si më poshtë:

Federico Sagnotti - 1 aksion me vlerë 5.000 lekë, i cili zotëron 100% të kuotave.

NENI 10

(Aktivet e shoqërisë)

Shoqëria bëhet pronare e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme kur vlera e aseteve në total paraqitet në vlerë monetare. Shoqëria nuk është përgjegjëse për kompensimin për tokën e blerë nga shteti prej ish-pronarëve.

NENI 11

(Pronësia mbi aksionet)

Aksionet e kapitalit aksioner dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre janë të transferueshme në këto mënyra:

- Kontribut në kapitalin e Shoqërisë
- Shitje e aksioneve
- Trashëgimi
- Dhurim
- Në çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

NENI 12

(Forma e transferimit)

Pavarësisht nga natyra e kalimit të pronësisë së aksioneve, kërkohet miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Transferimi i kapitalit aksioner duhet të paraqitet sipas ligjit, në të kundërt transferimi do të anulohet.

NENI 13

(Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit)

Kapitali i shoqërisë mund të rritet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Rritja e kapitalit vendoset kur është e nevojshme për interesat e shoqërisë, duke aplikuar përqindje shtesë për ortakët.

Ortakët themelues mund të vendosin për uljen e kapitalit të shoqërisë.

Ulja e kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët dhe nuk duhet të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi përpara publikimit të uljes së kapitalit. Përkundrazi, Gjykata me kërkesën e kreditorëve, mund ta konsiderojë këtë vendim të pavlefshëm.

NENI 14

(Fondi rezervë)

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të adresuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e saj financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 15

(Përdorimi i të ardhurave neto)

Arkëtimet neto që rezultojnë pas shlyerjes së shpenzimeve të bëra për realizimin e çdo lloji veprimtarie, vlerës së amortizimit, taksave, kuotave që rrisin kredinë për investime, pagave dhe kompensimeve, do të përdoren nga ortakët.

NENI 16

(Buxheti dhe plani i dytë financiar)

Asetet e shoqërisë vlerësohen në bilancet e saj në monedhën shtetërore ose në valutë të huaj sipas vlerësimit të ortakëve ose ekspertëve.

Bilanci vjetor paraqitet brenda afateve ligjore në vitin pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet në përputhje me format e bilanceve të përcaktuara nga Republika e Shqipërisë.

Plani financiar parashikon aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, të shprehura në lekë ose në monedhë të konvertueshme. Pasqyra e të ardhurave do të mbahet në Shqipëri.

Këmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas do të bëhet sipas kursit të këmbimit të monedhës zyrtare ose private.

NENI 17

(Shpërndarja e fitimit)

Ortakët kanë të drejtë të bëjnë shpërndarjen e fitimeve të deklaruara në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Fitimi shpërndahet në raport me pronësinë mbi aksionet.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 18

(Asambleja e Përgjithshme)

Organi themelues i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime që kërkojnë 3/4 e votave në rastet e mëposhtme:

1. Ndryshime në statut;
2. Rritje dhe zvogëlim i kapitalit;
3. Riorganizim dhe shpërndarje e shoqërisë;
4. Shpërndarje e fitimeve;
5. Raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

Për rastet e tjera si më poshtë, merret vendim me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës:

- Miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çështje të parashikuara nga ligj dhe statuti;
- Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve;
- Emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Përcaktimi i shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- Mbikqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, duke përfshirë përgatitjen e raporteve financiare vjetore dhe ecurinë e veprimtarisë;
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Ndarja e aksioneve dhe anulimi i tyre;
- Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e mosmarrëveshjeve me administratorët.

NENI 19

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar të thirret në të gjitha rrethanat sa herë që mbledhja është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqërisë në rastet e mëposhtme:

Sipas pasqyrave financiare vjetore ose raporteve financiare të ndërmjetme, qëndron ose ekziston rreziku që asetet e shoqërisë të mos mbulojnë detyrimet e kërkuara brenda tre muajve të ardhshëm.

Shoqëria propozon të shesë ose të disponojë në mënyra të tjera asete të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5% të aktiveve të shoqërisë, sipas pasqyrave financiare të fundit të audituara.

Brenda dy viteve të para pas regjistrimit, shoqëria propozon të blejë nga një aksioner pasuri të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5% të aktiveve të shoqërisë, sipas pasqyrave financiare të fundit të audituara.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 më sipër, para asamblesë së përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një kontabilist i pavarur i autorizuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 më sipër, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një vendim të rekomanduar duke miratuar ose duke bërë konstatime në lidhje me veprimtarinë e administratorëve.

NENI 20

(Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme)

Asambleja e Përgjithshme mblidhet me njoftim me shkrim ose me email. Njoftimi me shkrim ose me email duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është mbledhur siç është parashikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për t'i marrë ato vendime, pavarësisht nga parregullsitë.

NENI 21

(Kuorumi i nevojshëm dhe vendimet)

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, të cilat kërkojnë shumicë të thjeshtë, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve. Në rast se asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrim ose me postë.

Në rastet kur Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më sipër, Asambleja mblidhet jo më vonë se 30 ditë më pas me të njëjtën axhendë.

Ortakët që nuk janë të pranishëm kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, duke përfshirë edhe mjetet elektronike, me kusht që të garantohet verifikimi i identitetit të ortakëve.

Ortaku, i cili pengohet të ushtrojë të drejtat që rrjedhin prej pronësisë mbi aksionet e shoqërisë, ka të drejtë të kërkojë nga gjykata ndalimin e shkeljes ose shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e shkeljes së këtyre të drejtave.

NENI 22

(Procesverbali i mbledhjes së asamblesë)

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendimit, rendin e ditës, emrat e kryetarit dhe të personit përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Raportit i bashkëngjitet edhe lista e personave të pranishëm si dhe akti i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënkruhet nga drejtori dhe personi që mban procesverbalin.

NENI 23

(Hetimet speciale)

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të fillojë një hetim të posaçëm për parregullsitë në veprimet e themeluesit të shoqërisë ose në ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të numrit të përgjithshëm të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, ose një numër më të ulët të përcaktuar në statutin e shoqërisë, dhe/ose çdo kreditor i shoqërisë, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme caktimin e një eksperti të pavarur të fushës kur nuk ka dyshime mbi shkeljen e ligjit apo të statutit. Në rast të kundërt, brenda 30 ditëve pas refuzimit të asamblesë për të caktuar një ekspert të pavarur, autoriteti gjyqësor mund të kërkojë caktimin e eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa konsiderohet e refuzuar.

E drejta për të kërkuar hetim të veçantë duhet të ushtrohet brenda 3 viteve nga data e themelimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka për objekt parregullsitë e procesit të themelimit, dhe brenda 3 viteve nga data e veprimit i cila konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka të bëjë me parregullsi në ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në rast të vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rënda të ligjit ose statutit.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme ose çdo kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme shfuqizimin e përcaktuar më lart, ose mund të procedojnë pranë gjykatës brenda 30 ditëve nga data e refuzimit të kërkesës nga ana e asamblesë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve ose e kreditorëve konsiderohet e refuzuar.

Procedimi para gjykatës ndiqet nga një përfaqësues i shoqërisë i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët ose ortakët e përmendur më sipër kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të shoqërisë kur kanë dyshime se përfaqësimi e tij nuk është në përputhje me interesat e shoqërisë. Rastet e veçanta të hetimeve dhe të shfuqizimit të vendimeve do të rregullohen nga nenet 91 dhe 92 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 24

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Kohëzgjatja e emërimit nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet; me të drejtën e riemërimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të përcaktojë rregulla specifike për emërimin e administratorëve.

Administratori i shoqërisë, i cili pranon, do të jetë z. FEDERICO SAGNOTTI.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, edhe në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili e ushtron këtë kompetencë në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 25

(Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve)

Administratorët kanë të drejtat dhe detyrimet e:

1. Kryerjes së të gjitha akteve administrative të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësimit të shoqërinë;
3. Kujdesit për mirëmbajtjen e rregullt të dokumentacionit dhe librave kontabël të shoqërisë;
4. Hartimit dhe nënshkrimit të pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportit të ecurisë së aktivitetit dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. Krijimit të një sistemi të paralajmërimit të hershëm të rrethanave, të cilat kërcënojnë ecurinë e aktivitetit dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryerjes së regjistrimeve dhe dërgimit të të dhënave të detyrueshme të shoqërisë, sipas ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
7. Realizimit të raporteve para asamblesë së përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për zbatimin e aktiviteteve specifike me rëndësi të veçantë për shoqërinë;
8. Kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në statut;
9. Thirrjen e asamblesë së përgjithshme kur shoqëria brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak aktive të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5% të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrën financiare të fundit të certifikuar dhe në rast se, sipas pasqyrave financiare vjetore ose raporteve financiare të ndërmjetme, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë të mos mbulojnë detyrimet e kërkuara brenda tre muajve në vazhdim. Asambleja e Përgjithshme mund të zëvendësojë administratorin në çdo kohë me shumicë të thjeshtë. Statuti ose marrëveshjet e tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë. Kërkesa, në lidhje me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëveshjeve kontraktore me shoqërinë, rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 26

(Shpërblimi i administratorëve)

Paga bazë e administratorëve mund të rritet me përqindje fitimi ose të ngjashme. Shpërblimi i administratorëve përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme. Shpërblimi duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe situatën financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të zvogëlojë shpërblimin e administratorëve në masë të përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, kompensimit individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostos së shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 27.

(Ekspertët kontabël të autorizuar)

Shoqëria do të caktojë një ekspert kontabël të autorizuar për çdo vit financiar të parashikuar me ligj. Emërimi bëhet nga administratori i shoqërisë me akt emërimi.

Eksperti kontabël i autorizuar është përgjegjës për mirëmbajtjen e rregullt të dokumentacionit të shoqërisë.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit kontabël të autorizuar ortaku themelues, administratori, personat që kanë lidhje gjaku me ta deri në shkallën e katërt.

VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 28

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nga dispozitat e Aktit të Themelimit, nga Statuti i shoqërisë dhe nga legjislacioni shqiptar i punës.

Punësimi në Shoqëri arrihet përmes kontratës individuale të punës ndërmjet Shoqërisë dhe punonjësve të saj.

NENI 29.

Personeli administrativ dhe bashkëpunëtorët janë përgjegjës për çdo dëm që i shkaktojnë shoqërisë për faj të tyre dhe janë përgjegjës ndaj tyre civilisht.

VI SHPËRNDARJA E SHOQËRISË. LIKUIDIMI

NENI 30.

Kjo shoqëri shpërndahet në rast se:

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendim;
2. Fillohet procedura e falimentimit;

3. Nuk ushtron veprimtari tregtare prej dy vitesh dhe nuk është shpallur pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të ligjit nr.9723, nenit 43, datë 05.03.2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

4. Është shpallur një vendim gjyqësor

5. Për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

Shpërndarja e shoqërisë regjistrohet nga Administratorët në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 31

(Likuidimi i shoqërisë)

Shpërndarja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurës së likuidimit për pagesën, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e caktuar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas shpërndarjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues. Çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë nga gjyqtari zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesi i caktuar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e emërimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin në rast se shoqëria shpërndahet me vendim gjykate.

Likuiduesi shkarkohet ose zëvendësohet me të njëjtat kushte, sipas dispozitave të parashikuara për emërimin e tij. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe aftësitë e tyre për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Gjithashtu, likuiduesit njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit për çdo ndryshim të identitetit dhe të të drejtës së përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet kryesisht nga gjyqtari, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 05.03.2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Me hapjen e procedurës së likuidimit emri i shoqërisë regjistrohet dhe ndiqet me shënimin “në likuidim”. Likuiduesit duhet të njoftojnë dhe të ftojnë kreditorët e shoqërisë që të paraqesin kërkesat e tyre për shpërndarjen e shoqërisë brenda 30 ditëve. Likuiduesit marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve që nga data e emërimit të tyre.

NENI 32

(Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesve)

Detyrimet e likuiduesve janë mbyllja e të gjitha operacioneve të shoqërisë, mbledhja e kredive të papaguara dhe kontributeve të papaguara, shitja e aktiveve të shoqërisë dhe pagesa e kreditorëve sipas shkallës së përparësisë, sipas nenit 605 të Kodit Civil, likuiduesit mund të kryejnë veprimtari të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të pretendimeve të kreditorëve, likuiduesit vërejnë se aktivet e shoqërisë, përfshirë edhe kontributet e papaguara, nuk janë të mjaftueshme për shlyerjen e pretendimeve të kreditorëve, likuiduesit detyrohen të pezullojnë procedurën e likuidimit dhe të kërkojnë nga gjykata kompetente hapjen e procedurës së falimentimit.

NENI 33

(Bilancet)

Likuiduesit përgatisin një bilanc të gjendjes së shoqërisë në momentin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në momentin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit edhe raportin financiar të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 34.

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së borxheve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në shpërndarjen e fitimeve, me përjashtim të rasteve kur në statut është parashikuar një shkallë përparësie.

Aktivët, të cilat janë marrë nga shoqëria me qira ose në përdorim, me çdo lloj titulli u kthehen ortakëve.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për mbylljen e likuidimit dhe kërkon shpërndarjen e shoqërisë.

NENI 35.

Likuidim i thjeshtuar

Shoqëria mund të likuidohet me procedurë të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur ata kanë deklaruar para gjykatës se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer dhe të gjitha marrëdhëniet me punëtorët janë zgjidhur.

Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Mbi Qendrën Kombëtare të Biznesit", njoftojnë për regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të vendimit për likuidimin e shoqërisë, me procedurë të thjeshtuar.

Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrimeve gjatë likuidimit të thjeshtuar. Përveç administratorëve, edhe ortakët e shoqërisë përgjigjen bashkërisht deri në shumat e marra.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 36.

Ky statut hyn në fuqi me miratimin dhe regjistrimin e Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 37

Çdo gjë që nuk parashikohet në Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligjet e tjera përkatëse që janë në fuqi në Republikën Shqiptare.

NENI 38

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, dhe 4 (katër) në gjuhën italiane dhe është nënshkruar pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES:

Federico Sagnotti

Firma



FEDERICO SAGNOTTI